



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVLJA - MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	01
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	05-8348
Nr. faqeve Br. stranaica No. pages	-52-
Data: Datum: Date:	21/12/2023
Prishtinë / a	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health  
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

**Nr.203/XII/2023**  
**Datë:20.12.2023**

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7, 01 Mars 2019), nenin 11, paragrafi 1.5 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në Shtojcën 1, pika 6.1 Rregullores (QRK) - nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, duke u bazuar në nenin 16 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2019 për Udhërrëfyes dhe Protokolle Klinike nxjerr:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet Udhërrëfyesi Klinik për përdorimin e Azot Oksidulit ( N2O/O2) si sedacion inhalator në praktikën e Stomatologjisë.
- II. Shtojce e këtij vendimi është, Udhërrëfyesi Klinik për përdorimin e Azot Oksidulit ( N2O/O2) si sedacion inhalator në praktikën e Stomatologjisë.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

**Dr. Arben Viti**  
**Ministër i Shëndetësisë**

**Vendim i dërgohet:**

- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamenti ligjor;
- Arkivit të MSh.



**Udhërrëfyes Klinik**  
**për përdorim të**  
**Azot Oksidulit (N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>)**  
**si sedacion inhalator në**  
**praktikën Stomatologjike**

Prishtinë, Shtator 2023

## **Përmbajtja**

---

I. Shkurtesat .....	4
II. Anëtarët e grupit punues që kanë hartuar udhërrëfyesin .....	5
III. Komentet e recenzentëve .....	6
IV. Pyetjet Klinike .....	7
V. Kriteret e auditushme për zbatim .....	8
VI. Rekomandimet dhe nivelet e dëshmisë .....	9

### **Pjesa I**

1. Hyrje .....	11
2. Qëllimi dhe fokusi i udhërrëfyesit për sedacion inhalator .....	11
3. Qëllimi i përdorimit të sedacionit inhalator .....	12
4. Kufizimet dhe sfidat në sedacionin inhalator me N <sub>2</sub> O/O <sub>2</sub> .....	12
5. Popullata e synuar .....	13

### **Pjesa II**

1. Nivelet e anksozitetit dhe fobisë në stomatologji .....	14
2. Nivelet e sedacionit .....	14
3. Mënyrat e administrimit të sedativëve .....	15

### **Pjesa III**

1. Përkufizimi i sedacionit inhalator .....	16
2. Sedacioni inhalator N <sub>2</sub> O/O <sub>2</sub> (Azot Oksidul/Oksigjen) .....	16
3. Azot Oksidul (N <sub>2</sub> O) .....	17
3.1 Mekanizmi i veprimit të N <sub>2</sub> O .....	17
3.2 Efektiviteti i N <sub>2</sub> O .....	18
3.3 Efikasiteti i Azot Oksidulit në menaxhimin e sjelljes .....	18
3.4 Siguria e përdorimit të sedacionit inhalator N <sub>2</sub> O/O <sub>2</sub> .....	19
3.5 Siguria profesionale (e personelit) .....	21
4. Efektet e padëshiruara të inhalimit me N <sub>2</sub> O/O <sub>2</sub> .....	22
5. Seti i paisjeve emergjente .....	24
6. Teknika e administrimit të sedacionit inhalator N <sub>2</sub> O/O <sub>2</sub> .....	24

### **Pjesa IV**

1. Indikacionet dhe kundërindikacionet për sedacion inhalator .....	26
2. Bashkveprimi i sedacionit inhalator N <sub>2</sub> O/O <sub>2</sub> me barna tjera .....	27
3. Personeli .....	27
4. Trajnimet .....	29
4.1 Trajnimi për sedativim i profesionistëve të stomatologjisë .....	30



4.1.1	Asistentet e stomatologjisë	30
4.1.2	Higjienistët dental	30
4.2	Vazhdimi i zhvillimit profesional	30
5.	Ambienti	30
6.	Aparatura	31
7.	Vlerësimi i pacientit para sedacionit inhalator	31
8.	Pregatitja për sedatim inhalator	34
8.1	Përgjegjësitë e stomatologut referues	34
8.2	Përgjegjësitë e stomatologut trajtues	34
8.3	Anamneza	34
8.4	Egzaminimi dhe planifikimi i trajtimit	34
9.	Pëlqimi	34
10.	Udhëzimet para dhe pas sedacionit inhalator	35
11.	Ushqimi para sedacionit inhalator	35
12.	Shoqërimi	35
13.	Premedikimi oral	35
14.	Monitorimi	36
15.	Dokumentimi	37
16.	Rikuperimi nga sedacioni inhalator	37
17.	Lirimi i pacientit nga salla e intervenimit	38
18.	Udhëzimet për kujdesin në shtëpi pas sedacionit inhalator	38
19.	Sedacioni inhalator me ruajtje të vetëdijes për fëmijët	38
20.	Sedacioni për personat me nevoja të veçanta	39
21.	Menaxhimi klinik	39

## **Pjesa V**

1.	Metodologjia e zhvillimit të udhërrëfyesit	40
2.	Rekomandimet për hulumtime të mëtejme	41
3.	Rishikimi dhe përditësimi	41
4.	Impakti dhe benefitet shëndetësore potenciale të udhërrëfyesit në shoqëri, popullatë ose individ.	42
5.	Qëndrueshmëria financiare (sigurimi i Azot Oksidulit)	42
XI.	Referencat	42
XII.	Apendiksi 1	49
XIII.	Apendiksi 2	50



## *Shkurtesat*

---

1. O<sub>2</sub> - Oksigjeni
2. N<sub>2</sub>O – Azot Oksiduli
3. SNQ - Sistemi Nervor Qëndror
4. SDCEP - Scottish Dental Clinical Effectiveness Programme
5. GDG – Guideline Development Group
6. GRADE - Grades of Recommendation, Assessment, Development and Evaluation
7. SIGN - Scottish Intercollegiate Guidelines Network
8. ADA – American Dental Association
9. GABAA - Acidi gamma aminobutirik i tipit A
10. NMDA - N-metil-D-aspartat
11. ASA – American Society of Anesthesiologists
12. NICE – National Institute for Health and Care Excellence
13. EAPD – European Academy of Paediatric Dentistry
14. AAPD – American Academy of Pediatric Dentistry
15. BSPD – British Society of Paediatric Dentistry
16. MAC – Maximum Alveolar Concentration
17. CSA – Council on Scientific Affairs
18. CDP – Council on Dental Practice
19. NIOSH – National Institute for Occupational Safety and Health
20. OSHA – Occupational Safety and Health Administration
21. BLS – Basic Life Support
22. OSK - Oda e Stomatologëve të Kosovës
23. GDC - General Dental Council
24. HSAC – Health Services Advisory Committee of the Health
25. ADN – Acidi Deoksiribonukleik (Deoxyribonucleic acid)
26. AGREE - Appraisal of Guidelines for Research and Evaluation Enterprise

## *Anëtarët e grupit punues që kanë hartuar udhërrëfyesin*

---

- **Blerta Latifi-Xhemajli**, specialiste e Pedodoncisë dhe Stomatologjisë Preventive/Stomatologji
- **Petrit Raka**, specialist i Pedodoncisë dhe Stomatologjisë Preventive/Stomatologji
- **Jehona Ahmedi**, specialiste e Kirurgjisë Orale/Stomatologji
- **Blerina Kurshumlia**, Anesteziologe
- **Mentor Syla**, Divizioni i Farmacisë/MSh
- **Hajrullah Fejza**, DZhSSH/MSh

Bashkëpunëtorë:

- **Dr. Agreta Gashi**, anesteziologe

Recensentët:

- **Dr. Teuta Kutillovci**, specialiste e Pedodoncisë dhe Stomatologjisë Preventive/Stomatologji
- **Dr. Aida Rexhepi**, specialiste e Pedodoncisë dhe Stomatologjisë Preventive/Stomatologji

## *Komentet e recenzentëve*

---

Grupi punues për Adaptimin e Udhërrëfyesit Klinik për përdorim të Azot Oksidulit (N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>) si sedacion inhalator në praktikën Stomatologjike, ka propozuar komisionin recensues në përbërje të:

1. Dr. Aida Rexhepi, spec. e Pedodoncisë dhe Stom. Preventive
2. Dr. Teuta Kutllovci, spec. e Pedodoncisë dhe Stom. Preventive

Në cilësinë e recenzentëve konkludojmë se udhërrëfyesi paraqet në mënyrë shumë të qartë rëndësinë e përdorimit të sedacionit inhalator me N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub> në praktikën stomatologjike.

Ai është shkruar me një gjuhë të qartë, duke dhënë një përshkrim kronologjik rreth gjithë asaj që sot dihet për sedacionin inhalator me N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>.

Materiali është i ndarë në disa kapituj duke shpjeguar fillimisht se çfarë është sedacioni inhalator me N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>; Indikacionet dhe kundërindikacionet; Efektet e padëshiruara; Siguria profesionale; Trajnimi i kërkuar; Teknika e administrimit të sedacionit inhalator dhe shumë të tjera.

Literatura e përdorur është e mbështetur në numër të konsiderueshëm të udhërrëfyesve dhe publikimeve ndërkombëtare. Kjo ka ndihmuar në futjen e koncepteve bashkëkohore në lidhje me aspekte të ndryshme rreth sedacionit inhalator me N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>.



## *Pyetjet Klinike*

---

Ky udhërrëfyes adreson këto pyetje klinike:

- Çfarë është sedacioni inhalator dhe Azot Oksiduli (N<sub>2</sub>O)?
- Cili është mekanizmi i veprimit të N<sub>2</sub>O?
- Cilat janë nivelet e anksozitetit/fobisë në stomatologji dhe nivelet e sedacionit?
- Cilat janë mënyrat e administrimit të sedativëve?
- Cili është efikasiteti i Azot oksidulit në menaxhimin e anksozitetit, fobisë dhe sjelljes te pacientët?
- Sa është i sigurt përdorimi i sedacionit inhalator me N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>?
- Çfarë njohurish dhe trajnime duhet të posedojë personeli mjekësor që aplikojnë sedacionin inhalator?
- Cila është aparatura dhe ambienti për të aplikuar Azot oksidulin?
- Cilat janë prioritetet kryesore për implementimin e sedacionit?
- Cilat janë indikacionet dhe kundërindikacionet për sedacion inhalator?
- Cilat janë efektet e padëshiruara të inhalimit me N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>?
- Çfarë bashkëveprimi ka sedacionit inhalator N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub> me barna tjera?
- Si arrihet siguria profesionale (e personelit) gjatë përdorimit të N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>?
- Cili është seti i paisjeve emergjente që duhet pasur në ordinancën stomatologjike kur përdoret sedacioni inhalator?
- Si bëhet administrimi, monitorimi dhe dokumentimi i sedacionit inhalator N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>?
- Si zbatohet sedacioni inhalator me ruajtje të vetëdijes për fëmijët?
- Si zbatohet sedacioni për personat me nevoja të veçanta?
- Si arrihet rikuperimi nga sedacioni inhalator?
- Si dhe kur bëhet lirimi i pacientit nga salla e intervenimit dhe cilat janë udhëzimet për kujdesin në shtëpi pas sedacionit inhalator?

### *Kriteret e auditushme për zbatim*

---

- Numri i pacientëve që vlerësohen se kanë nevojë për trajtim stomatologjik nën sedacion inhalator,
- Numri i pacientëve me nevoja të veçanta,
- Numri i pacientëve me anksiozitet,
- Numri i pacientëve tek të cilët trajtimi stomatologjik bëhet nën sedacionin inhalator,
- Suksesi i trajtimit stomatologjik nën sedacion,
- Numri i ekstraksioneve të dhëmbëve nën sedacion,
- Numri dhe suksesi i trajtimeve endodontike nën sedacion.

## **Rekomandimet dhe nivelet e dëshmisë**

Të gjitha rekomandimet e përdorura në këtë udhërrëfyes janë zbatuar sipas Scottish Dental Clinical Effectiveness Programme për të ndihmuar në vendimmarrje klinike dhe secili rekomandim konsiderohet i rëndësishëm për ofrimin e kujdesit stomatologjik të kualitetit të lartë.

Rekomandimet bazohen në:

- Legjislacionin aktual dhe rregulloret profesionale
- Koncenzusi i Grupit për zhvillimin e udhërrëfyesit (GDG) pas vlerësimit kritik të evidencave në dispozicion
- Koncenzusi i Grupit për zhvillim të udhërrëfyesit pas marrjes në konsideratë të mendimit të ekspertëve

Simbolet në pjesën e majtë të udhërrëfyesit përfaqësojnë bazën për rekomandime siç përshkruhet më poshtë dhe jo rëndësinë e tyre klinike.

**Tabela 1. Baza për rekomandime**

Simboli	Baza për rekomandim
<b>A</b>	Këto rekomandime janë kërkesat ligjore legjislative ose profesionale prandaj konsiderohen të detyrueshme
<b>B</b>	Këto rekomandime mbështeten nga dëshmi të forta me paragjykim (Bias) të limituar (Niveli 1++/1+/2++/2+)*
<b>C</b>	Këto rekomandime mbështeten nga dëshmi të dobëta me potencial për paragjykim (Bias) ( Niveli 2+/ 3)
<b>D</b>	Këto rekomandime mbështeten në koncenzusin e mendimit të ekspertëve (Niveli 4)

\*Studimet e nivelit 2+ konsiderohen si dëshmi të forta kur dizajni i studimeve është i duhur për të adresuar pyetjen e cila do të shqyrtohet. Si kontrast, studimet e nivelit 2+ konsiderohen si dëshmi të dobët kur nuk janë dizajn i duhur: psh, kur evaluohen terapi të ndryshme.



Dëshmitë e përdorura për të mbështetur rekomandimet janë shënuar me nivele sipas kualitetit dhe përshkruhet më poshtë. Kjo skemë është zhvilluar nga SIGN. Nivelet e evidencave janë shënuar në anën e majtë të udhërrëfyesit.

**Tabela 2. Lloji i evidences sipas kualitetit**

<b>Niveli i dëshmisë</b>	<b>Lloji i evidencës</b>
<b>1++</b>	Meta-analiza me cilësi të lartë, Rishikimet sistematike të hulumtimeve të randomizuara të kontrolluara (RCT – Randomised Controlled Trials)), ose RCT me rrezik shumë të ulët të paragjyqimeve (njëanshmërisë – Bias) konfuzionit
<b>1+</b>	Meta-analiza të sukseshme, Rishikime sistematike ose RCT me rrezik të ulët të paragjyqimeve
<b>1-</b>	Meta-analiza të suseshme, Rishikimet sistematike ose RCT me rrezik të lartë të paragjyqimeve
<b>2++</b>	Rishikimet sistematike të cilësisë së lartë të studimeve të rasteve (Case Report) ose studimeve kohorte (Cohort Studies) Studime me cilësi të lartë të rasteve ose studime me kohortë me rrezik shumë të ulët të konfuzionit (ngatërrimit) ose anshmërisë dhe me probabilitet të lartë që marrëdhënia është e qëllimshme.
<b>2+</b>	Studime të sukseshme të rastit ose studime me kohortë me rrezik të ulët të konfuzionit ndaj paragjyqimeve dhe probabilitet të moderuar se marrëdhënia është e qëllimshme.
<b>2-</b>	Studimet case-control ose cohort me rrezik të lartë të konfuzionit ndaj paragjyqimeve dhe probabilitet të lartë se marrëdhënia është e qëllimshme.
<b>3</b>	Studimet joanalitike (psh. Case report, case series)
<b>4</b>	Mendimet e ekspertëve



## Pjesa I

### *1. Hyrje*

Ky udhërrëfyes është disajnuar për profesionistët shëndetësor që t'ju ndihmojë të ofrojnë kujdes më të mirë për pacientët në fushën e stomatologjisë. Ofron informacione për menaxhim dhe zbatim të lehtë të sedacionit inhalator me Azot Oksidul (N<sub>2</sub>O).

Trajtimi bashkëkohor në stomatologji ka rritur numrin e procedurave diagnostike/terapeutike që mund të jenë shqetësuese apo të dhimbshme për pacientin, nga të cilat pacientët mund të kenë frikë dhe ankth dhe shumë prej tyre pranojnë ti nënshtrohen këtyre trajtimeve vetëm me sedacion efektiv ose anestezion.

Zgjedhja mes sedacionit dhe anestezionit varet nga lloji i trajtimit. Profesionistët shëndetësor vendosin a është i nevojshëm sedacioni apo anestezioni.

Tek të rriturit, shumë trajtime stomatologjike ndërmerren me anestezion lokal, te fëmijët dhe të rinjtë kjo shpesh është e pamundur për shkak të frikës, dhimbjes apo se ndërhyrjet kryhen te fëmijët me nevoja të veçanta prandaj nevojiten modalitete tjera të menaxhimit të sjelljes.

Ofrimi i kontrollit adekuat për anksozitet është pjesë integrale e punës në stomatologji. Sipas organizatave relevante të stomatologjisë kjo është e drejtë e pacientit edhe detyrë që i parashtrohet stomatologut.

Të gjithë pacientët meritojnë kontroll adekuat të anksozitetit për çfarëdo procedure në stomatologji. Që të jenë adekuate metodat e përdorura duhet të mirret në konsideratë se çdo pacient individual i nënshtrohet trajtimit specifik. Qasja “një metodë i përshtatet të gjithëve” është joadekuate, prandaj duhet të ofrohen disa opsione.

### *2. Qëllimi dhe fokusi i udhërrëfyesit për sedacion inhalator*

Ky udhërrëfyes ka për qëllim të promovojë praktikën e mirë nëpërmjet rekomandimeve për ofrimin e sedatimit inhalator në stomatologji i cili është edhe i sigurtë edhe efektiv.

Udhërrëfyesi mund të aplikohet te të gjithë pacientët që i nënshtrohen sedatimit inhalator për të lehtësuar ofrimin e çfarëdo lloji të trajtimit stomatologjik pa marrë parasysh ku ofrohet: në ambulancë stomatologjike, qendra të ofrimit të shërbimeve stomatologjike apo spital.

Synimi i udhërrëfyesit është të ndihmojë profesionistët shëndetësor që të vendosin se kur sedacioni inhalator është zgjidhje e sigurtë dhe efektive për trajtim stomatologjik të pacientëve me qëllim të

reduktimit të dhimbjes dhe ankthit. Dokumenti mbulon vlerësimin, përgatitjen, trajnimin dhe monitorimin e nevojshëm gjatë përdorimit të sedacionit.

Në këtë udhërrëfyes nuk janë të përfshirë pacientët të cilët kanë nevojë për ventilim të asistuar, sedatimi në kujdesin intenziv, premedikimi për anestezion të përgjithshëm, analgjezion postoperative apo sedatimi në kujdesin paliativ.

### ***3. Qëllimi i përdorimit të sedacionit inhalator***

---

Qëllimet e përdorimit të sedacionit inhalator me N<sub>2</sub>O gjatë procedurave diagnostike ose terapeutike në stomatologji përfshijnë nevojat edhe të pacientëve edhe të stomatologëve.

Për pacientin qëllimet janë:

- të lehtësohet përballja me trajtimin,
- të reduktohet frika dhe ankthi gjatë trajtimit,
- të parandalohet frika dhe ankthi nga stomatologu dhe intervenimet stomatologjike,
- të rritet kontrolli i dhimbjes duke rritur pragun e ngacmueshmërisë së dhimbjes,
- të minimizohen lëvizjet e padëshirushme dhe reagimet ndaj trajtimit stomatologjik,
- të përmirësohet komunikimi dhe kooperimi i pacientit,
- të zvogëlohet refleksi i të vjellurit,
- të potencohet efekti i sedativëve,
- të rritet toleranca për trajtime më të gjata,
- të ndihmohet në trajtimet e pacientëve të paaftë mentalisht/fizikisht ose pacientëve me nevoja të veçanta mjekësore.

Rëndësia e secilit nga këto qëllime ndryshon në varësi nga natyra e procedurës stomatologjike dhe karakteristikat e pacientit.

Përdorimi i azot oksidulit e ndihmon stomatologun në punën e tij për:

- të lehtësohet zbatimin e trajtimeve stomatologjike,
- të zvogëluar stresin dhe emocionet e pakëndshme.

### ***4. Kufizimet dhe sfidat në sedacionin inhalator me N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>***

---

Sedacioni inhalator nuk është gjithmonë efektiv, prandaj duhet të vlerësohet mirë nëse pacienti është i përshtatshëm për trajtim stomatologjik me sedacion dhe ndonjëherë trajtimi duhet të shtyhet derisa pacienti të mund të nënshtrohet anestezionit të përgjithshëm, sepse dështimi i sedacionit për pacientin është shqetësues e poashtu ka implikime të mëdha edhe në institucion.



Disa nga kufizimet për përdorimin e sedacionit inhalator me N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub> mund të jenë:

- mungesa e forcës së pacientit (plogështia) për të qëndruar ulur në karrikën stomatologjike,
- shqetësimi psikologjik i pacientit,
- maska e hundës mund pengojë administrimin e anestezionit në regjionin anterior maksillar,
- kur pacienti nuk mund të marrë frymë nëpërmjet hundës,
- ndotja nga N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub> dhe rreziku nga ekspozimi i mundshëm i stafit profesional.

Sfidat me të cilat përballet profesionisti shëndetësor gjatë aplikimit të sedacionit inhalator me N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub> janë:

- rruga e frymëmarrjes është fushë e njëjtë e punës së stomatologut dhe sedacionit,
- fobia dhe anksoziteti i pacientit,
- sëmundjet koegzistuese si: anomali kongjenitale të zemrës, jostabilitet mendor dhe epilepsi,
- gjasat e aritmisë gjatë intervenimit kirurgjik për shkak të stimiulimit të nervit trigeminal,
- tonzilat dhe adenoidet e rritura që te fëmijët mund të ngushtojnë rrugët e frymëmarrjes,
- rreziku nga humbja e vetëdijës së pacientit,
- depresioni respirator dhe kardiovaskular,
- sinkopa vazovagale nga pozita e detyrueshme e këmbëve në karrigën stomatologjike.

Stomatologu duhet të jetë i përgatitur të përballet me të gjitha sfidat e paparashikuara dhe ti menaxhojë. Duhet të bëjë egzaminim të mirëfilltë para sedatimit në mënyrë që të vlerësohen rrugët e frymëmarrjes, sistemi kardiorespirator, çdo anomali kongjenitale dhe të dokumentohet historia e mjekimit apo e alergjisë.

## **5. Popullata e synuar**

---

Ky udhërrëfyes mbulon moshën mbi tri vjeçare.

## Pjesa II

Shkaku kryesor i përdorimit të sedacionit inhalator në stomatologji janë frika dhe anksoziteti nga ambienti i punës, stomatologu, mjetet apo aparatura stomatologjike si dhe gjendjet e ndryshme shëndetësore të cilat e pamundosojnë trajtimin e nevojshëm stomatologjik.

### *1. Nivelet e anksozitetit dhe fobisë në stomatologji*

Nivelet e anksozitetit të pacientit në stomatologji mund të klasifikohen në:

- **Anksozitet i ulët deri mesatar** – janë pacientët më të zakonshëm që shihen në ordinancën stomatologjike. Këta pacientë nuk kanë frikë joracionale nga stomatologu, sidoqoftë ndiejnë një fomë të anksozitetit derisa afrohet çasti i trajtimit. Kjo frikë nuk i parandalon nga paraqitja në ordinancë ngase dëshira e tyre për mirëmbajtjen e higjienës dhe shëndetit oral si dhe çlirimi nga dhimbja tejkalon frikën për shmangje të trajtimit sepse i dijnë pasojat. Sidoqoftë derisa janë në ordinancën stomatologjike vërehen disa shenja të anksozitetit: i djersiten shuplakat, kanë tahikardi dhe pranojnë se më me dëshirë do të ishin diku tjetër.
- **Anksozitet mesatar** – këta pacientë identifikohen më së lehti, pasi zakonisht shmangin kujdesin rutinor. Zakonisht vijnë në ordinancë me problem para se të shëndrrohet në emergjencë. Shenjat e tyre të frikës dallohen nga: ricaktimi i terminit stomatologjik rutinor, shenjat dhe simptomat e frikës në dhomën e pritjes dhe karrigë stomatologjike. Këta pacientë ulen në karrigë, mirëpo mund të bëhen hiper-reaktiv ndaj stimulimit taktil. Klinikisti duhet të kërkojë lejen për të bërë edhe egzaminimin e thjeshtë stomatologjik.
- **Anksozitet të rëndë** – këta pacientë janë të rrallë, mirëpo krijojnë problem të dyfishtë edhe për stomatologun edhe ekipin përcjellës. Ata i vonojnë trajtimet deri në ekstrem. Në vend të trajtimit vetëm të brengës fiziologjike (dhimbje, infeksion) duhet të trajtohet edhe emergjenca psikologjike. Dhimbja dentale potencohet nga frika e pacientit nga dhimbja duke krijuar qark vicioz. Nëse nuk menaxhohet frika e pacientit, trajtimi stomatologjik krijon më shumë stres dhe e rritë frustrimin edhe të stomatologut edhe ekipit përcjellës duke e ngritur më tej frikën dhe mosbesimin që ndjen pacienti.

### *2. Nivelet e sedacionit*

Përkufizimet e sedacionit (anestezionit) të përdorur në këtë udhëzim bazohen në ato të Shoqatës Amerikane të Anesteziolegëve (ASA) dhe ndahen në:

- **Analgjezion:** zvogëlim dhe eliminim i dhimbjes.
- **Anestezion lokal:** eliminim i ndjesisë, veçanërisht dhimbjes në një pjesë të trupit nga aplikimi lokal ose injektimi i anestetikut.



- **Anestezion minimal:** gjendje e shkaktuar nga barnat gjatë së cilës pacienti është zgjuar, i qetë dhe reagon normal ndaj urdhërave verbale. Edhe pse njohja dhe koordinimi mund të jenë të dobësuar, funksionet respiratore dhe kardiovaskulare janë të ruajtura.
- **Anestezion i moderuar:** deprimim i vetëdijes i shkaktuar nga barnat, gjatë të cilit pacientët janë të përgjumur, i përgjigjen urdhërave verbale ose stimulimit të lehtë me prekje. Ventilimi spontan është i mjaftueshëm. Funksioni kardiovaskular zakonisht ruhet. Ky është lloji i anestesioneit i cili zakonisht përdoret në stomatologji.
- **Anestezion i thellë:** deprimim i vetëdijes i shkaktuar nga barnat, gjatë të cilit pacienti është në gjumë, nuk mund të përgjigjet në qetësi, por reagon ndaj ngacmimeve të përsëritura ose të dhimbshme. Mund të preket funksioni respirator. Ventilimi duhet të monitorohet dhe pacienti mbahet nën intubim. Funksioni kardiovaskular zakonisht ruhet.
- **Anestezion i përgjithshëm:** deprimim i vetëdijes i shkaktuar nga barnat, gjatë të cilit pacienti nuk reagon në ngacmim (dhimbje). Funksioni respirator mbahet me ventilim nën presion pozitiv (intubimi me tub endotraheal). Mund të preket sistemi kardiovaskular.

Për shkak se sedatimi dhe anestezi i përgjithshëm janë një vazhdimësi nuk mund të dihet gjithmonë si do të reagojë pacienti. Për këtë shkak profesionisti që ka qëllim të arrijë nivel të caktuar të sedatimit duhet të jetë i aftë të diagnostikojë dhe menaxhojë pasojat fiziologjike duke bërë reanimim të pacientit kur niveli i sedatimit bëhet më i thellë se niveli i dëshiruar në fillim.

### **3. Mënyrat e administrimit të sedativëve**

Për të zvogëluar ankthin dhe frikën nga trajtimet stomatologjike përdoren sedativët/qetësuesit të cilët mund të administrohen me rrugë të ndryshme për të lehtësuar qasjen e pacientit ndaj procedurave stomatologjike. Mënyrat e administrimit të sedativëve mund të jenë:

- **enteral** – çdo teknikë e administrimit në të cilën agjenti absorbohet nëpërmjet traktit gastroenteral ose mukozë orale (psh oral, sublingual, rektal).
- **parenteral** – teknika e administrimit me anë të së cilës bari anashkalon traktin gastrointestinal (psh, intramuskular [IM], intravenoz [IV], intranazal [IN], submukozal [SM], subkutan [SC] intraoseal [IO]).
- **transdermal** – teknikë e administrimit me anë të cilës bari administrohet me fashë ose jontoforezë nëpërmjet lëkurës.
- **transmukozal** – teknikë e administrimit me anë të cilës bari administrohet nëpërmjet mukozës si: intranazal, sublingual ose rektal.
- **inhalimi** – teknikë e administrimit me të cilën agjentët e gaztë (të avullueshëm) aplikohen në mushkëri, efekti primar i të cilëve është absorbimi nëpërmjet sipërfaqes ajër/gjak.



## Pjesa III

### 1. Përkufizimi i sedacionit inhalator

Definicioni i sedacionit inhalator me ruajtje të vetëdijes së pacientit përkufizohet si: “Metodë nëpërmjet të cilës duke përdorë një ose disa medikamente shkaktohet deprimim i sistemit nervor qëndror (SNQ) dhe mundësohet kryerja e trajtimit stomatologjik, gjatë të cilit pacienti është me vetëdije dhe gjatë gjithë kohës së sedatimit është i mundur kontakti verbal me të.” (National Dental Advisory Committee, General Dental Council, Standing Dental Advisory Committee dhe Dental Sedation Teachers Group)

Është me rëndësi të veçantë që niveli i sedatimit duhet të jetë i tillë që pacienti të mbetet me vetëdije dhe të jetë i aftë të kuptojë dhe të përgjigjet urdhërave verbale. Nëse pacienti nuk mund të përgjigjet kontaktit verbal (p.sh. personat me probleme me dëgjim) dhe është plotësisht i vetëdijshëm, gjatë punës duhet të zbatohet metoda e zakonshme e pacientit për komunikim.

Medikamentet dhe metodat që përdoren për sedacion inhalator me ruajtje të vetëdijes së pacientit gjatë trajtimit stomatologjik duhet të kenë siguri të mjaftueshme për të arritur qëllimin - ruajtjen e vetëdijes. Çdo teknikë që rezulton me humbje të vetëdijes definohet si anestezion i përgjithshëm.

### 2. Sedacioni inhalator Azot Oksidul / Oksigjen ( $N_2O/O_2$ )

Për sedacion inhalator në stomatologji përdoret përzierja: Azot Oksidul  $N_2O$  dhe Oksigjen  $O_2$ . Përdorimi i  $N_2O$  njihet kohë të gjatë si në anesteziologji ashtu edhe në stomatologji. Metoda e titrimit në përqëndrime të ulëta të  $N_2O$  me  $O_2$  është përdorur për trajtim në stomatologji që nga 1889 në shumë vende (SHBA, Kanada, Britani të Madhe, Australi dhe Skandinavi) dhe njihet si metodë e sukseshme klinike, me kosto efektive në krahasim me anestezionin e përgjithshëm.

Kur përdoret në mënyrë të duhur sedacioni inhalator  $N_2O/O_2$  është masë e duhur për menaxhim të sigurtë, efektiv të dhimbjes dhe ankthit në stomatologji. I referuar si “sedacion me ruajtje të vetëdijes së pacientit” ose “sedacion me Azot Oksidul” përzierja e inhaluar  $N_2O/O_2$  është anestetiku i gaztë më i përdoruri në botë. Sipas sondazhit nga ADA (American Dental Association) më 2007 vlerësohet se 70% të ordinancave stomatologjike në SHBA përdorin ndonjë formë të sedatimit që përmban  $N_2O/O_2$ .

Anestetikët inhalator duke përfshi  $N_2O/O_2$  absorbohen dhe shpërndahen si rezultat i ndryshimit të shtypjes në mushkëri duke qarkulluar kur tensioni i gasit të inspiruar barazohet me atë në alveole, gjak dhe inde. Gazrat të cilat kanë tretshmëri të ulët në gjak dhe indin dhjamor siç është  $N_2O$  ekuilibrohen shumë më shpejtë; kjo paraqet forcën shtytëse për agjentët inhalator të futen në indet e trurit, ku edhe ndodhë efekti anestetik. Nga të gjithë agjentët inhalator  $N_2O$  e ka shfaqjen më të shpejtë të efektit. Nëpërmjet gjakut transportohet si gas i lirë; nuk kombinohet me hemoglobinin dhe nuk i nënshtrohet biotransformimit. Tretshmëria e dobët e tij lejon që  $N_2O$  të eliminohet shpejtë nga organizmi. Eliminimi sistematik i tij ndodh me ekshalim pulmonar.



Sipas ADA udhëzuesi për sedativ dhe anestezi (adoptimi 2016) N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub> i inhaluar kur përdoret në kombinim me agjent sedativ mund të zhvillojë sedacion minimal, të moderuar, të thellë apo anestezi të përgjithshëm.

### **3. Azot Oksiduli (N<sub>2</sub>O)**

Azot Oksiduli është gaz pa ngjyrë, pothuajse pa erë por me ndjesi lehtësisht të ëmbël. Është agjent anksiolitik/analgetik efektiv i cili përdoret si sedativ inhalator. Shkakton depresion të sistemit nervor qendror (SNQ), shkallë të ndryshme të relaksimit muskular, eufori dhe ka efekt minimal në sistemin respirator.

N<sub>2</sub>O ka veprim të shpejtë sepse absorbohet shpejtë nga alveolet dhe në serum qëndron si tretje e thjeshtë. Relativisht është i patretshëm, depërton nëpër inde dhe qeliza tjera të organizmit, poashtu edhe në SNQ. Ekskretohet shpejtë nëpërmjet mushkërive. N<sub>2</sub>O shkaktonte depresion minimal të sistolës kardiake, ndërsa lehtësisht e rritë rezistencën periferike dhe në këtë mënyrë mirëmbahet presioni i gjakut. Kjo posaqërisht paraqet përparësi në trajtimin e pacientëve me çrregullime të sistemit cerebrovaskular.

N<sub>2</sub>O absorbohet shpejt nga alveolet ashtu që edhe shfaqja e efektit të tij edhe këndellja janë të shpejta (përbrenda 2-3 min). Shkakton zvogëlim minimal të çfarëdo refleksi dhe në këtë mënyrë ruhet refleksi i kollitjes. Përdorimi i tij ka profil superior të sigurisë, nuk është regjistruar rast i morbiditetit serioz apo fatalitet kur është përdorë përbrenda koncentrimëve të rekomanduara.

#### **3.1 Mekanizmi i veprimit të N<sub>2</sub>O**

Autorët Emmanouil dhe Quock në vitin 2007 kanë shpjeguar mekanizmin e veprimit, vetitë analgetike, anksiolitike dhe anestetike të N<sub>2</sub>O por të cilat ende nuk janë të sqaruara plotësisht.

N<sub>2</sub>O ka disa mekanizma të veprimit të cilat janë:

- **Efekt i analgetik** - fillon nga lirimi neuronal i peptideve endogjene opioide të cilët aktivizojnë receptorët opioid, rrugët zbritëse të acidit gamma aminobutirik të tipit A (GABAA) dhe rrugët noradrenergjike, të cilat modifikojnë përpunimin nociceptiv në nivelin spinal duke inhibuar rrugët e dhimbjes nëpërmjet receptorëve opioid.
- **Efekt i anksiolitik** - përfshin aktivizimin e GABAA receptorëve, ose në mënyrë direkte ose indirekte sepse është agonist i vendit të lidhjes së benzodiazepinës në receptorin GABAA dhe potencion rrugët sinjalizuese që përfshijnë sintazën e oksidit nitrik, guanilil ciklazën e tretshme dhe protein kinazën cGMP - të varur.
- **Efekt i anestetik** - shkaktohet nga inhibimi i N – metil – D – aspartat (NMDA) glutamat receptorit, kanal joselektiv i joneve që lidhet me glutaminin i cili përfshihet në plasticitetin e sinapsave dhe krijimin e memories. Kështu largon ndikimin ngacmues në sistemin nervor.



### 3.2 Efektiviteti i N<sub>2</sub>O

Sedacioni me N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub> preferohet për trajtim në stomatologji për shkak të kufijve të gjerë të sigurisë dhe efekteve minimale në funksionet respiratore dhe kardiovaskulare. Ndihmon posaqërisht në parandalimin dhe menaxhimin e anksozitetit të fëmijët. Në bazë të hulumtimeve, gati 1/5 e fëmijëve të moshës 10-14 vjeçare kanë frikë nga trajtimet stomatologjike, prandaj sedacioni me N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub> është mjet posaqërisht i dobishëm në menaxhimin e sjelljes për pacientët fëmijë. Sipas studimeve, dështimi i trajtimit nën sedacion duket se shoqërohet me eksperiencë të vogël të operatorit me çka potencohet rëndësia e trajnimit të personelit.

Ndonjëherë anestezioni i përgjithshëm duket se është opcioni i vetëm i munshëm për pacientët fëmijë me anksozitet të lartë dental. Sidoqoftë fëmijët të cilët i nënshtrohen anestezionit të përgjithshëm mund të vuajnë nga frika e hyrjes në anestezion të përgjithshëm i cili lidhet me morbiditet postoperativ duke përfshi ndjenjën e mundimit dhe mungesën e gjumit të mirë me simptoma që zgjasin deri një javë.

Studimet të rriturit janë më të rralla por udhërrëfyesit ndërkombëtar e rekomandojnë sedatimin N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub> si teknikën e parë për të rriturit. N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub> mund të jetë alternativë më e këndshme, më kostefektive se anestezioni i përgjithshëm me efekt si format tjera të sadatimit kur administrohet nga personeli i trajnuar te pacienti i duhur dhe me paisje të duhura.

### 3.3 Efikasiteti i Azot Oksidulit në menaxhimin e sjelljes

Frika, ankthi dhe dhimbja mund të modifikohen dhe menaxhohen me teknika të ndryshme psikologjike, mirëpo në shumë raste ato nuk mjaftojnë dhe është e nevojshme qasja farmakologjike. Njëri nga agjensët farmakologjik për menaxhimin e sjelljes së pacientit gjatë trajtimit stomatologjik është N<sub>2</sub>O i cili së bashku me teknikat e menaxhimit të sjelljes është efikas edhe për fëmijët edhe për të rriturit.

Sipas rishikimit të Cochrane databazës ka përmirësim të sjelljes ose ankthit kur përdoret N<sub>2</sub>O. Sipas (NICE 2010) përdorimi i N<sub>2</sub>O si "metodë standarde" në stomatologjinë e fëmijëve tregon sukses deri në 90% të rasteve. Sipas këshillit të Stomatologëve të Evropës përdorimi i N<sub>2</sub>O është i sigurtë, efikas në menaxhimin e ankthit dhe dhimbjes së pacientëve gjatë trajtimit në stomatologji. Akademia Europiane e Stomatologjisë Pediatrike (EAPD), Akademia Amerikane e Stomatologjisë Pediatrike (AAPD) dhe Shoqëria Britanike e Stomatologjisë Pediatrike (BSPD) rekomandojnë metodën e titrimit (shtimi i N<sub>2</sub>O në O<sub>2</sub> për 5 deri në 10 % çdo një minutë ose duke përcjellur vetëdijen e pacientit derisa të arrihet efekti qetësues i dëshiruar).

Para se të vendoset për përdorim të sedacionit inhalator me N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub> për efekt analgjezik, ansiolitik duhet të mirren parasysh modalitetet alternative të menaxhimit të sjelljes, nevojat për trajtim stomatologjik të pacientit, efekti i kualitetit të trajtimit/kujdesit stomatologjik, zhvillimi emocional i pacientit dhe statusi fizik i pacientit.



Në përgjithësi, N<sub>2</sub>O pranohet nga fëmijët dhe mund të titrohet lehtë. Shumica e fëmijëve janë entuziastë dhe lehtë pranojnë administrimin e N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>. Pas fillimit të efektit sedativ shumë fëmijë kanë raportuar ndjenjën e xigëlimës ose senzacionin e ngrohtësisë. Objektivisht fëmijët shihen me duar të hapura, këmbë të lëshuara dhe pamje të relaksuar të fytyrës. Sidoqoftë për disa pacientë ndjenja e humbjes së kontrollit mund të jetë shqetësuese dhe fëmijët me klaustrofobi mund të përtjetojnë maskën e hundës si kufizuese dhe të pakëndshme.

#### 5.4 Siguria e përdorimit të sedacionit inhalator N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>

N<sub>2</sub>O është gaz i cili nuk irriton traktin respirator, vepron dhe eliminohet shpejtë nga organizmi (për 2-3 minuta), ka tretshmëri të ulët në inde dhe përqendrimi minimal alveolar (MAC) i tij është sa një anestetik i dobët në presion normal të ajrit atmosferik. Efekti klinik i inhalimit N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub> mund të parashikohet te shumica e popullatës. Kur përdoret për analgjezion inhalimi N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub> lejon zvogëlimin ose eliminimin e dhimbjes dhe ankthit duke ruajtur vetëdijen e pacientit me rrezik minimal.

Për administrim të mirëfilltë të sedacionit inhalator me N<sub>2</sub>O egziston kufiri i sigurisë. Janë zhvilluar së paku 12 masa të sigurisë audio dhe vizuale të administrimit për të shmangur efektet e padëshiruara gjatë administrimit të N<sub>2</sub>O (Tabela 4). Përdoruesit duhet të dijnë ti përcjellin masat dhe të reagojnë menjëherë duke larguar maskën nga fytyra e pacientit që të lejohet thithja e ajrit të ambientit kur dyshohet se është duke dështuar ndonjëra nga masat e sigurisë.

Aparatura për sedacion inhalator nuk lejon nivel hipoksik të sedacionit pasi administron gazrat me kufi maksimal 70% N<sub>2</sub>O dhe asnjëherë më pak se 30% O<sub>2</sub>, kjo ndihmon të sigurohet se pacienti pranon së paku 9% më shumë O<sub>2</sub> se që është i pranishëm në ajrin e ambientit të punës. Në shumicën e rasteve arrihet analgjezion adekuat relativ me përqendrime të N<sub>2</sub>O që nuk kalojnë 50%. Suksesi i teknikës varet nga titrimi i duhur i N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>, përgjigjja individuale e pacientit dhe mbështetet nga teknikat e menaxhimit të sjelljes.

N<sub>2</sub>O mund të përdoret në kombinim me ndonjë bar enteral për sedatim minimal. Kur përdoret në kombinim me agjent qetësues shkakton sedatim minimal, mesatar, të thellë ose anestezion të përgjithshëm. Kur qëllimi është sedatimi minimal te të rriturit dozimi adekuat inicial i barit enteral nuk duhet të jetë më i madh se maksimumi i dozës së rekomanduar të barit i cili mund të përshkruhet për përdorim të pamonitoruar në shtëpi. Përdorimi i qetësuesit preoperativ në shtëpi për fëmijë (nën 12 vjet) duhet të shmanget, pos në situata të jashtzakonshme, për shkak të rrezikut të obstruimit të pavërejtur të rrugëve respiratore gjatë transportit nga persona të patrajnuar. Te fëmijët (nën 12 vjet) niveli i sedatimit mund të jetë mesatar edhe pse qëllimi është sedatimi minimal. Nëse kjo ndodh, duhet të zbatohet protokollin për sedatim mesatar.

Për shkak të pranisë të gazrave të ndezshme (N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>) gjatë sedacionit inhalator, ekziston rrezik nga zjarri. Prandaj, kërkohet instalim i sistemit për eliminim të gazrave me qark të mbyllur.



Ambienti i punës duhet të mbahet i sigurtë me mundësi të menaxhimit të lehtë të çdo rreziku të mundshëm. Rekomandohet të përcillen udhëzimet lokale për menaxhimin e rreziqeve në punë.

Adoptimi i procedurave të punës dhe rekomandimet nga Council on Scientific Affairs (CSA) dhe Council on Dental Practice (CDP) mund të ndihmojnë në përdorimin e N<sub>2</sub>O në mënyrë të sigurtë nëse zbatohen këto rregulla:

- çdo sistem i N<sub>2</sub>O duhet të jetë i pajisur me sistemin e largimit të mbetjeve të gazit. Flow metri që matë sasinë e qarkullimit të gasit duhet të jetë mirë i dukshëm, i mirëmbajtur për të siguruar saktësi. Sistemi duhet të ketë vakum pompën me kapacitet deri 45 litra të ajrit/min, poashtu dhe maska të madhësive të ndryshme që të sigurohet adoptimi i mirë për çdo pacient
- largimi i vakumit dhe gazrave (sistemi me vakum). Të mos vendoset sistemi shkarkues afër vrimës për marrje të ajrit të freskët. Të sigurohet që ventilimi i përgjithshëm siguron përzierje të mirë të gazrave në ambient. Ekspozimi kronik profesional – disa orë në javë – ndaj N<sub>2</sub>O rezidual në hapësirën punuese lidhet me efekte të padëshiruara shëndetsore.
- kur fillimisht kyqet sistemi gjithmonë të testohen lidhjet nën presion për rrjedhje, poashtu edhe kur ndërrohet bombola e gazit. Lidhjet (gypat) nën presion të lartë duhet të testohen për rrjedhje së paku një herë në tre muaj. Mund të përdoret sapun i lëngshëm duke e lyer mbi gypa (tuba) dhe lidhje për të testuar rrjedhjet. Si alternativë për ti testuar rrjedhjet mund të përdoret spektrometri portativ me rreze infra të kuqe.
- para përdorimit të parë ditore të sistemit, duhet të inspektohen të gjitha komponentet: rezervoari, ambu maska, gypat, maskat, lidhjet – për dëmtime, çarje, vrima ose çkyrje dhe të zëvendësohet çdo pjesë e dëmtuar.
- pasi të kontrollohen të gjitha pjesët mund të lidhet maska me gypat dhe aktivizohet vakum pompa. Të sigurohet se sasia e rrjedhjes së gazrave është korrekte – deri 45 litra në minutë ose sipas rekomandimeve të prodhuesit.
- maska duhet ti përshtatet mirë secilit pacient. Kontrollon qe ambu maska të mos mbushet as tepër as më pak përderisa pacienti thith O<sub>2</sub> para se të fillohet me ajër i likim e N<sub>2</sub>O.
- pacienti duhet të limitojë të folurit gjatë administrimit të N<sub>2</sub>O dhe të përpiqet të marrë frymë nëpërmjet hundës – nëse është e mundur duhet të shmangë frymëmarrjen nëpërmjet gojës.
- gjatë administrimit të shikohet për ndryshim në volumin e ambu maskës, poashtu të vëzhgohet sasia e qarkullimit në vakum pompë.
- pas procedurës aplikohet 100% O<sub>2</sub> për 5 minuta para largimit të maskës nga pacienti. Kjo mundëson pastrimin e sistemit nga N<sub>2</sub>O reziduale dhe largon barin nga pacienti.
- periodikisht (preferohet çdo 6 muaj) personeli – posaçërisht ata që punojnë në administrimin e N<sub>2</sub>O – mund të egzaminohen ndaj ekspozimit. Kjo bëhet duke vendosur dozimetrat ose me vendosjen e spektrometrit me rreze infra të kuqe në dhomën e punës.

Hulumtimi i National Institute for Occupational Safety and Health (NIOSH) thekson se mirëmbajtja e sistemit, ventilimi i mirë dhe procedurat e mirëfillta të punës praktike mundën në mënyrë efektive të ulin koncentrimin e N<sub>2</sub>O në hapësirat punuese në 25 ppm (45mg për m<sup>3</sup>) gjatë



administrimit të sedacionit inhalator (limiti i ekspozimit i rekomanduar nga NIOSH). Edhe pse nuk ka standard formal nga Occupational Safety and Health Administration (OSHA) për gazin N<sub>2</sub>O ose gazra tjerë anestetik, ai është i përfshirë në udhërrëfyesin e OSHA "Anesthetic Gases: Guidelines for Workplace Exposures".

### 5.5 Siguria profesionale (e personelit)

N<sub>2</sub>O në mënyrë ireversibile e oksidon vitaminën B<sub>12</sub>, e ulë aktivitetin e enzimeve që varen nga vitamina B<sub>12</sub> (metionin dhe timidilat sintetazat). Ky është zakonisht mekanizmi për efektet e padëshiruara mjekësore që paraqiten te individët që ekspozohen në mënyrë kronike ndaj sasive në gjurmë të barit si: infertiliteti, aborti spontan, diskrazionet e gjakut dhe deficieti neurologjik.

Në literaturën mjekësore, ekspozimi afatgjatë ndaj gazit N<sub>2</sub>O të përdorur si anestetik lidhet me supresionin e palcës kockore dhe çrregullime në sistemin riprodhues. Sidoqoftë, është treguar se ventilimi adekuat është efektiv në minimizimin e efekteve në sistemin riprodhues. Si masë për të zvogëluar rreziqet shëndetësore nga N<sub>2</sub>O që lidhen me profesion, AAPD rekomandon që ekspozimi i personelit në ambientin me N<sub>2</sub>O gaz të minimizohet nëpërmjet përdorimit të sistemeve efektive të eliminimit/largimit të gazit të mbetur, kontrolleve të rregullta dhe mirëmbajtjes së sistemeve për administrim dhe eliminim të gazit. Klinikistët duhet të përpiqen të minimizojnë bisedën e pacientit dhe frymëmarrjen e tij me gojë gjatë administrimit të N<sub>2</sub>O për të parandaluar që gazi i ekspiruar të kontaminojë ambientin e punës.

Ekspozimi kronik i personelit ndaj N<sub>2</sub>O lidhet me efekte të ndryshme anësore që përfshijnë abortin spontan, supresionin e palcës kockore, sëmundje të mëlçisë, sëmundje të veshkëve dhe sëmundje neurologjike. Sidoqoftë dëshmitë për këto efekte janë konfliktuoze dhe të dobëta sepse shumica janë studime retrospektive të prirura për paragjykim (bias) ose studime me mostra të vogla. Është raportuar edhe rreziku për sistem riproduktiv por dëshmitë janë të pamjaftueshme. Health Services Advisory Committee of the Health (HSAC) dhe Safety Commission kanë konkluduar se nuk ka dëshmi të mjaftueshme të dëshmohet rreziku riproduktiv te njerëzit. Sidoqoftë, Paterson dhe Tahmassebi (2003) këshillojnë personelin që pret ose mundohet të bëjë fëmijë të shmangen ekspozimit (N<sub>2</sub>O).

Disa hapa mund të ndërmerren që të zbutet rreziku profesional prej ekspozimit të zgjatur ndaj N<sub>2</sub>O. Në Mbretërinë e Bashkuar rekomandohet niveli i ekspozimit prej <100 ppm gjatë periudhës mesatare referente prej 8 orëve. Kontrollet e rregullta të N<sub>2</sub>O në ambient janë të rëndësishme që të sigurohet që sistemi i largimit (ventilimi) është efektiv dhe i mirëmbajtur.

Me ventilim efektiv rreziku nga ekspozimi profesional është i parëndësishëm. Psh në Singapur niveli i lejuar i ekspozimit afatgjë (koncentrimi maksimal mesatar në kohë të caktuar i N<sub>2</sub>O gjatë cilës individë mund të ekspozohet gjatë orarit të punës 8 orë në ditë/40 orë në javë) është 50 ppm.



## 6. Efektet e padëshiruara të inhalimit me N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>

Azot Oksiduli lidhet me shqetësimet për ambientin për shkak të kontributit të tij në “efektin serrë” (mbetja e nxehtësisë në atmosferë në vend që të largohet në hapësirë). N<sub>2</sub>O emetohet në natyrë nga bakteret në tokë dhe oqean. Prodhohet edhe nga djegja e karburanteve fosile, maleve dhe praktikave të agrokulturës - kultivimi i tokës (fertilizimi me azot). Në efektin serrë N<sub>2</sub>O kontribon me rreth 5% nga tërë sasia. Sidoqoftë vetëm fraksion i vogël i totalit të N<sub>2</sub>O të liruar në atmosferë (0.35–2%) është me të vërtetë rezultat i aplikimit mjekësor të gazit N<sub>2</sub>O.

Analgjezioni me N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub> ka rezultat të shkëlqyer të sigurisë kur administrohet nga personeli i trajnuar të pacientët e përzgjedhur me kujdes, me aparaturë të duhur dhe teknikë adekuate.

Efektet e padëshiruara akute dhe kronike të N<sub>2</sub>O te pacientët janë shumë të rralla. Efekti më i shpeshtë i padëshiruar që shfaqet te 0.5-1.2% e pacientëve janë nauzea dhe vjellja. Incidenca më e lartë vërehet te administrimet më të gjata të N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>, lëkundje të nivelit të N<sub>2</sub>O, mungesa e titrimit, rritja e koncentrimit të N<sub>2</sub>O dhe marrja e sasisë më të madhe të ushqimit para administrimit të N<sub>2</sub>O.

Studimet tregojnë rezultat negativ në lidhje me përdorimin e N<sub>2</sub>O me koncentrim më të lartë se 50% ose si anestetik të intervenimeve të mëdha kirurgjike. Edhe pse i rrallë mund të ndodhë regurgitim i qetë dhe aspirim pasues gjatë sedatimit me N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>. Brenga qëndron në faktin se a do të ruhet intakt refleksi faringo-laringeal. Ky problem shmanget duke mos lejuar pacientin të kalojë në gjendje pa vetëdije.

Disa nga efektet e padëshiruara që mund të shfaqen pas inhalimit të N<sub>2</sub>O janë:

**Hipoksia** – aparatet moderne stomatologjike për administrim të N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub> obligohen të administrojnë minimum 30% O<sub>2</sub>, nivel ky që është më i lartë se O<sub>2</sub> në ambient. Masë tjetër parandaluese përfshin sistemin pin-index (lidhëse) për të siguruar lidhjen e saktë të tubave në dalje N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>. Sidoqoftë mund të ndodhë që tubat të lidhen gabimisht, p.sh. mund të shpëputet lidhja dhe të ndodhë hipoksia te pacienti kur N<sub>2</sub>O gabimisht administrohet nëpërmjet daljes për O<sub>2</sub>. Për këtë shkak janë të domosdoshme kontrollet e shpeshta.

**Hipoksia nga difuzioni** ndodh si rezultat i lirimit të shpejtë të N<sub>2</sub>O nga qarkullimi i gjakut në alveola duke zvogëluar koncentrimin e O<sub>2</sub> në gjak. Kjo shkakton kokëdhimbje, disorientim dhe nauze. Shmanget duke administruar 100% O<sub>2</sub> pasi të ndalon administrimi i N<sub>2</sub>O. Përderisa rekomandimi standard është të administrohet 100% O<sub>2</sub> në përfundim të trajtimit, disa studime kanë vënë në pyetje nevojën e këtij hapi në protokolin e N<sub>2</sub>O te pacientët e shëndoshë.

**Nauzea dhe vjellja** janë efekte anësore më të shpeshta (0.5% të pacientëve), ndodhin kur nuk përdoren metoda adekuate të titrimit, të hipoksia nga difuzioni dhe efekti i volumit të shtypjes. N<sub>2</sub>O tretet më pak se O<sub>2</sub> në gjak. Difuzioni i shpejtë i tij në alveole e zvogëlon koncentrimin e O<sub>2</sub>



alveolar dhe shkakton “hipoksi nga difuzioni”. Kjo ndodhë kur përdoret koncentrim i lartë i  $N_2O$  (që zakonisht nuk përdoret për sedacion në stomatologji), është e rrallë sepse administrohet së bashku me  $O_2$ . Parandalohet me administrim 100%  $O_2$  3-5 min gjatë këndelljes derisa të largohet  $N_2O$  nga qarkullimi i gjakut.  $N_2O$  futet më shpejtë në zbrastirat e organizmit të mbushura me ajër sa azoti dhe largohet më shpejtë nga to, p.sh. kavitetin e inflamuar timpanik. Rezultoni me rritje të presionit të gazrave në hapësirë që shkakton efekte të padëshiruara anësore p.sh. rakturë të membranës timpanike, prandaj kontraindikohet te pacientët me otitis media dhe pneumotoraks.

**Humbja e refleksive mbrojtëse** – Roberts dhe Wignall (1982) kanë vendosur ngjyrë radioopake në gjuhën e fëmijëve gjatë trajtimit stomatologjik me dhe pa sedatim. Radiografitë post operative kanë zbuluar mungesë të ngjyrës në laring dhe gjoks te pacientët të cilët i janë nënshtruar sedacionit inhalator. Kjo d.t.th. se ngjyra nuk është aspiruar gjatë sedacionit inhalator dhe me këtë është eliminuar frika nga depresioni i refleksit laringeal gjatë sedacionit me  $N_2O$ .

**Laringospazmi, desaturimi, apnea dhe sulmet** raportohen shumë rrallë edhe atë vetëm gjatë administrimit të dozave të larta të  $N_2O$  (50-70%) për trajtime mjekësore, më së shumti te fëmijët 3 vjeçar. Edhe pse nuk mund të përcaktohet lidhja mes këtyre efekteve të padëshirueshme serioze dhe administrimit të  $N_2O$ , dozat e larta nuk rekomandohen për aplikim nga stomatologët sepse pacientët mund të futen në shkallë më të thella të sedacionit me humbje potenciale të vetëdijes dhe dobësim të refleksive mbrojtëse.

**Efektet sistemike dhe përdorimi te pacientët me nevoja të veçanta mjekësore** – për dallim nga shumica e barnave që ekskretohen nëpërmjet veshkëve/mëlçisë,  $N_2O$  eliminohet nëpërmjet mushkërive pa metabolizëm. Për këtë shkak mund të përdoret në mënyrë të sigurtë te pacientët me sëmundje kronike të veshkëve ose mëlçisë.

Aparatet tipike stomatologjike për sedatim inhalator ofrojnë  $<0.5$  MAC (Koncentrimi maksimal alveolar) dhe kanë efekt minimal respirator dhe kardiak.  $N_2O/O_2$  inhalimi sygjerohet si alternativë për anestezion të përgjithshëm në menaxhim të pacientëve me nevoja të veçanta mjekësore. Presioni i lartë i  $O_2$ , vetitë anksiolitike dhe mesatarisht analgjezike janë me vlerë shumë të madhe te pacientët me anomali të zemrës, astmës së rëndë dhe anemisë sideropenike. Preferohet që vetëm pacientët e kategorisë ASA I/II të nënshtrohen sedacionit inhalator  $N_2O/O_2$  jashtë ambientit spitalor.

**Inhibimi i palcës kockore** –  $N_2O$  inaktivizon vit  $B_{12}$  me oksidim. Reagon me kobalaminën duke prodhuar radikale të lira të cilat kimikisht ndryshojnë enzimin metionin sintetazë. Të dy rrugët e çrregullojnë funksionimin e metionin sintetazës dhe ndikojnë në formimin e nukleotidit purin që si pasojë ndikon në sintezën e ADN në palcën kockore. Kjo formon bazë kimike për komplikime të lidhura me  $N_2O$  p.sh. anemi megaloblastike. Anemia megaloblastike raportohet te pacientët e ekspozuar ndaj 70%  $N_2O$  në kohëzgjatje prej 4 orë dhe 50%  $N_2O$  deri 24 orë. Sidoqoftë përdorimi i zgjatur i koncentrimëve të larta të  $N_2O$  është i parëndësishëm për sedacionin në stomatologji ku pacientët ekspozohen shkurt dhe me koncentrim të ulët të  $N_2O$ .



**Halucinacionet** – janë raportuar halucinacione seksuale gjatë sedacionit inhalator me N<sub>2</sub>O.

Stomatologët janë të rrezikuar nga denoncimet e abuzimit edhe atij seksual prandaj duhet të jenë tërë kohën të shoqëruar nga asistenti.

## **7. *Seti i paisjeve emergjente***

---

Paisjet e setit emergjent në ordinancë stomatologjike ku përdoret sedacioni inhalator N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>:

- stetoskopi,
- manzheta për matjen e tensionit (madhësi për të rritur dhe fëmijë),
- maska të fytyrës të tejdukshme,
- shiringa (1 ml, 2 ml, 5 ml, 10 ml),
- gjilpëra (madhësi 27 dhe 20),
- lëngje për tretje (ujë steril, 0.9 % tretje fiziologjike),
- sfungjerë të alkoolit,
- gazë,
- barna emergjente,
- oksigjen,
- adrenalinë (1:1000 ¼; 1 mg/ml x 3),
- aspirin,
- flumazenil (Romazikon, antagonist të benzodiazepinës).
- kortikosteroidet (Dexason, Urbazon)
- bronkodilatatorët (Salbutamol spray).

## **8. *Teknika e administrimit të sedacionit inhalator N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>***

---

Azot Oksiduli aplikohet me aparaturë të posaçme, të dizajnuar me qëllim të administrimit të sedacionit inhalator në stomatologji. Egzistojnë dy tipe të sistemeve të administrimit të N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>:

- **sistem mobil** (portativ) me rezervoarë-bombola që mund të lëvizë brenda sallave dhe
- **sistem qëndror** spitalor me rezervoarë të fiksuar që janë të lidhur me sistem me lidhje të shumfishta dhe mund të përdoret përnjëherë në shumë salla.

Mund të kenë panel analog ose digjital. Aparatet modern janë të dizajnuar me veçori të sigurisë së inkorporuar. Bombolat e N<sub>2</sub>O dhe O<sub>2</sub> janë të shënuara me ngjyra (zakonisht N<sub>2</sub>O kaltër, O<sub>2</sub> zi me rreth të bardhë, Singapur/UK). Edhe tubat kodohen me ngjyra dhe i korespondojnë ngjyrave të bombolave/cilindrave (kaltër për N<sub>2</sub>O; zi e bardh për O<sub>2</sub>, mirëpo jo gjithkund). Sistemi unik i kyqjeve/lidhjeve për secilin tub siguron përshtatje të saktë të tyre me gazin/bombolën përkatëse.

Teknika përfshin administrimin e koncentrimin subanestetik të N<sub>2</sub>O së bashku me O<sub>2</sub> nga aparati nëpërmjet maskës nazale. Sistemi i administrimit të N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub> prodhohet me paisjen dështim-siguri



të O<sub>2</sub> e cila ndalon menjëherë qarkullimin e N<sub>2</sub>O kur ndalon qarkullimi i O<sub>2</sub>. Është shumë e sigurtë pasi pacienti qëndron i zgjuar, reagon dhe i ka të ruajtura reflekset.

	Suksesi i teknikës varet nga titrimi adekuat i Azot Oksidulit për çdo pacient, nga reagimi individual i pacientit dhe mbështetet nga teknikat e menaxhimit të sjelljes. Aparaturat e dedikuara për sedatim inhalator nuk lejojnë nivelet hipoksike të sedatimit.	4
<b>D</b>	Teknika e rekomanduar për sedatim inhalator është përdorimi i dozës së titruar të Azot Oksidulit me Oksigjen	4
<b>A</b>	N <sub>2</sub> O/O <sub>2</sub> administrohet vetëm nga individë të trajnuar/licencuar ose nën përkujdesjen direkte të tyre. Personi përgjegjës për trajtim të pacientit dhe administrim të agjentit për analgjezion duhet të trajnohet në përdorimin e agjentëve të tillë dhe teknika për përgjigje emergjente (BLS).	4

Duhet të zgjedhet maska nazale me madhësi të duhur. Zakonisht nga gjithë pacientët pranohet sasia e qarkullimit prej 5-6 L/min. Sasia e qarkullimit rregullohet pas obzervimit të Ambu maskës që duhet të pulsojë lehtësisht me çdo frymëmarrje dhe duhet të mos jetë as tej as nën mbushur. Preferohet administrim 100% O<sub>2</sub> (1-2 min) që përcillet me titrim të N<sub>2</sub>O në interval nga 10%. Gjatë analgjezionit me N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub> koncentrimi i N<sub>2</sub>O nuk duhet të tejkalojë 50%.

Studimet kanë demonstruar se koncentrimi i gazrave të përziera në flow metër varion dukshëm nga koncentrimi i gazrave në alveole në fund të ekspiriumit dhe është përgjegjës për efektet klinike. Për të arritur sedatimin klinikistit duhet të komunikojë me pacientin (ta detyrojë të flasë) frymëmarrja me gojë të jetë në minimum dhe vakumi pastrues (scavenging) duhet të mos jetë aq i fortë sa të pengojë ventilimin adekuat të mushkërive me N<sub>2</sub>O.

Revju i shënimeve të pacientëve të cilët iu kanë nënshtuar sedatimit inhalator me N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub> ka treguar se pacientit të zakonshëm i nevojitet 30–40% N<sub>2</sub>O për arritje të sedatimit ideal. Koncentrimi i N<sub>2</sub>O mund të ulet për trajtimet e lehta stomatologjike (restaurime) dhe të rritet gjatë atyre më të rënda (ekstrahim, injeksion ose anestetik lokal). Sipas një studimi nuk është i domosdoshëm administrimi kontinuel i N<sub>2</sub>O pas arritjes së anestezionit maksimal.

Aparatet duhet të përmbajë mekanizmin e sigurisë (p.sh. nëse presioni i O<sub>2</sub> bie, furnizimi me N<sub>2</sub>O ndalon automatikisht); matës të posaçëm të përqendrimit të gazrave (O<sub>2</sub>/N<sub>2</sub>O); valvulë emergjente të ajrit; tub me rrjedhje njëdrejtimëshe të ajrit (që pamundëson rikthimin) dhe sistem efektiv për eliminimin e gazit të ekspiruar dhe të tepërt.

Gjatë trajtimit është me rëndësi të vazhdohet monitorimi vizual i respiracionit dhe nivelit të vetëdijes së pacientit. Efektet e N<sub>2</sub>O me të madhe varen nga qetësia psikologjike e pacientit. Për këtë shkak është me rëndësi të vazhdohet me teknikat e zakonshme të menaxhimit të sjelljes gjatë trajtimit. Pasi të ndërprehet administrimi i N<sub>2</sub>O duhet të administrohet 100% O<sub>2</sub> derisa pacientit ti rikthehet statusi i mëparshëm i vetëdijes (para trajtimit). Pacientit duhet ti rikthehet vetëdija në gjendjen si para trajtimit para se të mund të lirohet nga klinika për shtëpi.



## Pjesa IV

### *1. Indikacionet dhe kundërindikacionet për sedacion inhalator*

Sedacioni inhalator me N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub> mund të përdoret në gjitha fushat e stomatologjisë: trajtime të vogla, ekstraksione, trajtime endodontike, parodontologjike, apikotomi, implantologji etj.

**Indikacionet** për përdorimin e sedacionit inhalator me ruajtje të vetëdijes së pacientit (N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>) si ndihmesë në menaxhimin e pacientit përfshin pacientët me:

- ankth dhe fobi dentare,
- procedura dentare të zgjatura ose traumatike,
- gjendje shëndetësore që potencialisht përkeqësohet nga stresi (astma, epilepsia),
- gjendje shëndetësore që ndikon në aftësinë e pacientit për të bashkëpunuar,
- pacientët me nevoja të veçanta mjekësore,
- pacientët me refleks të shprehur të vjelljes që vështirëson trajtimin stomatologjik,
- pacienti tek i cili nuk mund të aplikohet anestezi lokal,
- fëmiju bashkëpunues i cili do të nënshtrohet trajtimit të zgjatur stomatologjik,
- fëmiju me status fizik I dhe II sipas ASA,
- fëmiju mjaft i pjekur për të kuptuar dhe bashkëpunuar (mbi 3 vjet),
- trajtime të pakëndshme stomatologjike si ekstraksione të dhëmbëve dhe menaxhimi i traumës akute të dhëmbëve,
- si alternativë e anestezionit të përgjithshëm,
- pacientët me çrregullim të tonusit muskular si paralizë cerebrale (për tu shmangur lëvizjet e pavullnetshme).

**Kundërindikacionet** për përdorim të sedacionit inhalator me ruajtje të vetëdijes së pacientit janë

- pamundësia për komunikim,
- pamundësia për të marrë frymë nga hunda (obstruksion nazal akut/kronik),
- deformitet nazal apo facial,
- infeksione momentale të traktit respirator të sipërm (ftohja, tonziliti, sinusiti),
- pacienti me sinusit ose operim të fushës së ORL (brenda 14 ditëve të fundit),
- çrregullimet e rënda psikiatrike,
- deficiti i Vitaminës B<sub>12</sub> (Kobalamina),



- sëmundjet kronike obstruktive pulmonare,
- skleroza multiple,
- miastenia gravis,
- trajtimi me bleomicin sulfat (kimioterapi),
- gratë në 6 muajt e parë të shatzanisë,
- shqetësime të kohëve të fundit të veshit të mesëm ose intervenime kirurgjike,
- disa varësi nga droga/barnat,
- deficienca e metilentetrahidrofolat reduktazës,
- fëmijët që janë shumë të rinj/vegjël për të kuptuar dhe bashkëpunuar (mosha nën 3 vjet),
- fobia nga maska e hundës,
- pneumothorax,
- hipertension intraokular ose operim të retinës.

Gjithmonë duhet të konsultohet specialisti përkatës mjekësor para administrimit të agjensëve analgjezik/anksiolitik te pacientët me gjendje të caktuara mjekësore (p.sh. sëmundje me obstrukcion të rëndë pulmonar, sëmundje kongjestive të zemrës, anemi sideropenike, otit akut të veshit të mesëm, grafi i membranës timpanike i vendosur kohëve të fundit, lëndimet akute të rënda të kokës. Për shtatzënat duhet konsultuar specialistin prenatal (gjinekologun/obstetrin) para përdorimit të N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub> analgjezionit/anksiolitikut gjatë shtatzënisë.

Pacientët e klasës ASA III dhe IV mund të trajtohen nën sedacion N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub> mirëpo trajtimi i tyre duhet të jetë në bashkëpunim me specialistët përkatës dhe në kushte hospitalore.

## ***2. Bashkëveprimi i sedacionit inhalator N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub> me barna tjera***

Azot Oksiduli mund të rrisë efektin e veprimit të sedativëve tjerë të cilët përdoren për sedacion të pacientëve për trajtim në stomatologji si psh. opioidëve, benzodiazepinëve duke shkaktuar depresion të SNQ. Nuk ka të dhëna të interaksionit të N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub> me barna tjerë.

## ***3. Personeli***

**A** Të gjithë anëtarët e ekipit të cilët zbatojnë trajtim me sedacion inhalator duhet të kenë trajnim të duhur teorik poashtu edhe trajnim nën kontroll praktik dhe klinik para aplikimit të pavarur në praktikën klinike.

Të gjithë anëtarët e ekipit stomatologjik duhet të jenë të trajnuar në menaxhimin e komplikimeve që lidhen me sedacion inhalator si shtesë ndaj kërkesave të zakonshme për ofrimin e teknikave të reanimimit dhe menaxhimit të emergjencave mjekësore.

**4**

**A**

Stomatologu, higjienisti dentar i cili merr përsipër përgjegjësinë për sedatim të pacientit dhe ofrimin e trajtimit stomatologjik duhet të asistohet nga personi i trajnuar. Ky person duhet të jetë prezent përgjatë gjithë trajtimit dhe të jetë i aftë të monitorojë gjendjen klinike të pacientit dhe të asistojë stomatologun në rast të ndonjë komplikimi. Personi i dytë i trajnuar mund të pranojë trajnim teorik ose praktik në shtëpi (online) nëse trajnimi dokumentohet plotësisht dhe është i kualitetit adekuat.

**4**

Kur anëtari i dytë ndihmës ofron sedatim inhalator, ekipi stomatologjik duhet të jetë prezent dhe i gatshëm gatshëm aftë të asistojë personin që kryen sedatimin në rast të ndonjë komplikimi.

Pjesëtari i personelit të trajnuar për sedatim duhet të përcjellë pacientin derisa ai të jetë i gatshëm për tu liruar në shtëpi.

**D**

Personeli duhet të jetë i vëmendshëm për gjendjet që përcjellin pacientin e sedatuar. Asnjë anëtar i personelit nuk duhet të qëndrojë i vetëm me pacientin e sedatuar për asnjë moment.

**4**

Nëse stomatologu punon me personin e paracaktuar që kryen sedatimin ose të punësuar nga stomatologu apo pala e tretë duhet të ketë përgjegjësi formale ose me kontratë për stomatologun i cili trajton pacientin për ti qartësuar përgjegjësitë dhe llogaridhënien për secilin anëtar të ekipit stomatologjik të përfshirë me secilin pacient gjatë pregtitjes, sedatimit, këndelljes dhe liritimit.

Profesionistët shëndetësor që aplikojnë sedacionin inhalator duhet të kenë njohuri për:

- farmakologjinë e barnave të cilat përdoren për sedacion,
- vlerësimin e fëmijëve dhe të rinjve,
- monitorimin,
- kujdesin rikuperues (kër dellja e pacientit),
- komplikimet dhe menaxhimin e menjëhershëm të tyre.

Profesionistët shëndetësor që aplikojnë sedacion inhalator duhet të kenë përvojë praktike në:

- aplikimin efikas të teknikës së zgjedhur të sedacionit dhe menaxhimin e komplikimeve,
- observimin e shenjave klinike (kalueshmëria e rrugëve të frymëmarrjes, shpejtësia dhe thellësia e frymëmarrjes, puls, zbehja, cianoza dhe thellësia e sedacionit)
- përdorimin e paisjeve monitoruese.



#### 4. Trajnimet

	Standardet për trajnim mbi sedatimin me ruajtje të vetëdijes së pacientit mund të gjinden në 'Training in Conscious Sedation for Dentistry'. Ky dokument ofron trajnim të detajuar të nevojshëm për stomatologun që të aplikojë sedacion intravenoz me Midazolam dhe sedatim inhalator me Azot Oksidul/Oksigjen. Trajnimi përfshin praktikën klinike të mbikqyrur.	4
<b>D</b>	Të gjithë ata që ofrojnë sedatim duke i përdorë këto teknika duhet të jenë të trajnuar sipas këtyre standardeve.	4
<b>D</b>	Të gjithë anëtarët e ekipit që ofrojnë trajtim stomatologjik nën sedacion inhalator duhet të kenë dëshmi të përditësuar të kompetencës që e fitojnë duke kryer trajnim të duhur teorik, praktik dhe klinik që mbulon parimet e praktikës së sedacionit, duke përfshirë sedacionin të fëmijët dhe të rinjtë, para aplikimit të pavarur në praktikën klinike.	4
<b>D</b>	Të gjithë anëtarët e ekipit duhet të trajnohen në menaxhimin e komplikimeve që lidhen me sedacionin inhalator me ruajtje të vetëdijes së pacientit.	4
<b>D</b>	Gjatë trajtimit stomatologu për asnjë moment nuk duhet të jetë i vetëm me pacientin nën sedacion inhalator. Ai duhet të asistohet nga personi i dytë i trajnuar, i cili duhet të jetë i pranishëm gjatë tërë kohës, të jetë në gjendje të monitorojë gjendjen klinike të pacientit dhe të ndihmojë në rast të ndonjë komplikimi.	4

Programi i trajnimit duhet të ketë qëllim arritjen e kompetencës të profesionistët, përbëhet nga:

- dhimbja dhe ankthi në stomatologji,
- historia e përdorimit të N<sub>2</sub>O,
- karakteristikat kimike, biokimike, fiziologjike, psikologjike të përdorimit të N<sub>2</sub>O,
- gama e aplikimit,
- indikacionet dhe kundër-indikacionet,
- siguria e pacientit,
- aspektet e kontamimit të hapësirës punuese (siguria e operatorit),
- paisja për përzierje dhe shpërndarje të gazrave,
- pjesa praktike (të sedatosh dhe të sedatohesh),
- ndihma e parë dhe reanimimi (Basic Life Support - BLS)
- aspektet ligjore (spjegohen në bazë të vendimeve që nxjerr Ministria e Shëndetësisë).

Këto trajnime organizohen nga kompanitë përgjegjëse (operatorët ekonomik) që duhet të jenë të akredituara dhe mbikqyrura nga Oda e Stomatologëve të Kosovës (OSK).



## 4.1 Trajnimi për sedatim i profesionistëve të stomatologjisë

### 4.1.1 Asistentet e stomatologjisë

**A** Infermieret e stomatologjisë të cilat asistojnë në sedatim inhalator duhet të jenë të trajnuara sipas standardeve. **4**

Infermierja e stomatologjisë mund të jetë asistent i përshtatshëm nëse ka kryer silabusin i cili përfshin sedatimin. **4**

### 4.1.2 Higjienistët dental

Higjienistët dentar e terapeutët mund të ofrojnë trajtim për pacientë të sedatuar nga personeli që është trajnuar duke përfshi praktikën klinike nën mbikqyrje. **4**

Personi që zbaton sedatimin duhet të jetë i pranishëm përgjatë tërë trajtimit dhe të jetë i gatshëm të ofrojë ndihmë.

## 4.2 Vazhdimi i zhvillimit profesional

Dëshmia mbi pjesmarrjen në edukim të vazhdueshëm profesional është kërkesë sipas statutit për të gjithë stomatologët e licencuar dhe profesionistët tjerë në stomatologji.

**D** Për personat e përfshirë në sedatim një pjesë e edukimit të vazhdueshëm profesional duhet të jetë e lidhur me këtë aspekt të praktikës së tyre dhe duhet të përfshijë të gjithë grupmoshat e pacientëve që i trajtojnë. **4**

## **5. Ambienti**

**A** Sedatimi inhalator në stomatologji duhet të zbatohet në ambient që është i përshtatshëm. Ambienti i tillë përfshin personelin, hapësirat dhe aparaturat të cilat janë të duhura për zbatimin e sedatimit inhalator. Duhet të mbahen shënime për të gjitha procedurat operative, vlerësimet e riskut dhe të dhënat e mirëmbajtjes dhe marrëveshjeve. **4**

**A** Salla e trajtimit dhe reanimimit duhet të jetë mjaft e madhe për të mundësuar qasje adekuate për ekipin shëndetësor dhe të ketë ventilim të mirë. Çdo ambient i punës për administrim të N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub> duhet të kontrollohet për administrim të sigurtë dhe efikas të gazit si dhe funksioneve dështim – siguri (failure – security) para përdorimit. **4**

Zonat e trajtimit dhe këndelljes duhet të jenë mjaftueshëm të mëdha për të mundësuar çasjen e ekipit për trajtim stomatologjik.

**A** Duhet të jenë në dispozicion të gjitha paisjet dhe barnat që nevoiten për trajtim emergjent mjekësor dhe të komplikimeve që lidhen me sedatim. Paisjet duhet të jenë funksionale ndërsa barnat përbrenda afatit të përdorimit. **4**

Zona e këndelljes mund të jetë dhomë e veçantë ose dhoma e trajtimit. Duhet të jetë e paisur që të mund të ofrohet menaxhimi i çdo komplikimi lidhur me sedatim.



## 6. Aparatura

Për administrim të sedacionit inhalator në stomatologji duhet të përdoren aparate speciale të cilat zakonisht janë portative. Aparatura që përdoret duhet të jetë në përputhje me standardet aktuale europiane, të mirëmbahet sipas udhëzimeve të prodhuesit duke bërë servisim të rregullt i cili duhet të dokumentohet.

**A** Cilindrat e gazit duhet të ruhen në mënyrë të sigurtë në përputhje me rregulloret dhe të sigurohen për të parandaluar lëndimet.

Aparatura duhet të ketë sistem adekuat për eliminim të gazit (ventilim) për të minimizuar kontaminimin e ajrit të sallës me çka zvogëlohet rreziku i personelit i cili punon me të.

Pulsoksimetri nuk është i domosdoshëm për sedatim inhalator.

Të gjitha paisjet dhe barnat që nevoiten për trajtim të urgjencave mjekësore dhe komplikimeve të cilat lidhen me sedacion inhalator duhen të jenë të disponueshme lehtë. Paisjet duhet të jetë në gjendje të rregullt dhe barnat brenda datës së skadencës.

Oksigjeni suplementar dhe paisjet e nevojshme për t'i dhënë pacientit oksigjen shtesë, duhet të jenë lehtë të disponueshme.

**D** Paisjet e inhalimit duhet të kenë kapacitet për të administruar 100% dhe jo më pak se 30% koncentrim të O<sub>2</sub> me rrjedhë të përshtatshme për moshën e fëmijëve.

Nëse paisja mundëson ofrimin e më shumë se 70% N<sub>2</sub>O dhe më pak se 30% O<sub>2</sub> duhet të përdoret analizatori i oksigjenit.

Në rast urgjence “Flush butoni” aktivizon qarkullimin e menjëhershëm të 100% O<sub>2</sub>.

Oksigjeni suplementar dhe paisjet e nevojshme për t'i dhënë pacientit oksigjen shtesë, duhet të jenë lehtë të disponueshme.

Paisja e inhalimit duhet të ketë sistemin dështim-siguri (Failure-Safety) që duhet të kontrollohet dhe kalibrohet rregullisht sipas rregullave dhe ligjeve të vendit.

## 7. Vlerësimi dhe përzgjedhja e pacientit para sedacionit inhalator

Duhet patjetër të bëhet vlerësimi i pacientit në vizitë të veçantë nga ajo e trajtimit me sedacion. Vlerësimi i kujdesshëm dhe i detajuar i pacientit është i nevojshëm për të siguruar vendimet e duhura sa i përket planifikimit të trajtimit.

**A** Së bashku me pacientin duhet të analizohen të gjitha teknikat relevante të menaxhimit të anksozitetit duke përfshirë edhe anestezionin e përgjithshëm që të sigurohet se sedatimi inhalator është forma më e përshtatshme.

**D** Nuk ka nevojë të dështojë njëra teknikë për të kaluar në tjetrën. Për këtë shkak duhet pasur konsideratë në statusin fizik të pacientit sipas ASA (American Society of Anaesthesiologists) kur vendoset ku duhet të aplikohet sedatimi.

Profesionistët shëndetësor duhet të jenë të trajnuar të bëjnë vlerësimin e pacientit para sedacionit inhalator dhe atë ta dokumentojnë në kartelën e pacientit. Analizimi i historisë mjekësore, anamnezës së pacientit duhet të bëhet para vendimit për të përdorë N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub> sedacionin inhalator.

Vlerësimi fizik dhe psikologjik në stomatologji konsiston nga këto tre komponente:

- Anamneza (pyetësi i historisë së pacientit),
- Egzaminimi fizik dhe
- Informatat e fituara nga biseda.

Me vlerësim të pacientit duhet të përcaktohen:

- gjendja aktuale shëndetësore e pacientit,
- gjendja fizike (përfshirë rrugët e frymëmarrjes),
- pesha e pacientit (vlerësimi i rritjes),
- statusi psikologjik dhe zhvillimor,
- sëmundjet, çrregullimet ose abnormalitetet fizike dhe statusi i shtatzënisë,
- sëmundjet e kohëve të fundit (psh. ftohja ose ngushtimi i rrugëve të frymëmarrjes) që mund të kompromitojnë rrugët e frymëmarrjes,
- problemet shëndetësore në të kaluarën (përfshirë ato që ndërlidhen me sedacion apo anestezi të mëparshëm),
- medikamentet që janë duke u marrë për momentin duke përfshi dozën, kohën, rrugën e marrjes dhe vendin e administrimit,
- hospitalizimet e mëparshme (të përfshihen data dhe shkak),
- alergjitë dhe reaksione të mëparshme alergjike ose të padëshirueshme ndaj barnave.

Qëllimet e vlerësimit fizik dhe psikologjik janë përcaktimi i aftësisë së pacientit të:

- tolerojë fizikisht stresin që do të shkaktohet në trajtimin e planifikuar stomatologjik,
- të vendoset nëse nevojitet modifikim i trajtimit për ti mundësuar pacientit që më lehtë të përballojë stresin nga trajtimi stomatologjik,
- të vendoset se cila teknikë e sedatimit është më e përshtatshme për pacientin,
- të vendoset nëse egzistojnë kontraindikacione për trajtimin e planifikuar stomatologjik apo çdo medikament që planifikohet të përdoret.



Me këto informata stomatologu mund të vlerësojë statusin fizik dhe psikologjik të pacientit (të përcaktojë kategorinë sipas ASA klasifikimit), vlerëson nëse ka nevojë për konsulta mjekësore dhe nëse indikohet, modifikon trajtimin e planifikuar stomatologjik.

Pacientët duhet të klasifikohen sipas rrezikut të tyre shëndetësor kur i nënshtrohen trajtimit stomatologjik – kirurgjik në hapësirën orale. Në bazë të këtij klasifikimi përcaktohen niveli i sedatimit dhe rruga e administrimit për të shmangur komplikimet apo emergjencat. Zakonisht përdoret sistemi i klasifikimit në bazë të statusit fizik sipas Shoqatës Amerikane të Anesteziologëve (ASA) i cili është në përdorim që nga viti 1962.

**Tabela 3. Klasifikimi i statusit fizik sipas ASA (American Society of Anesthesiologists)**

<b>ASA I</b>	Pacienti me shëndet normal.
<b>ASA II</b>	Pacienti me sëmundje të lehtë sistemike.
<b>ASA III</b>	Pacienti me sëmundje të rëndë sistemike.
<b>ASA IV</b>	Pacienti me sëmundje të rëndë sistemike që paraqet rrezik të vazhdueshëm për jetën.
<b>ASA V</b>	Pacienti në agoni për të cilin nuk pritet të mbijetojë pa operacion.
<b>ASA VI</b>	Pacient i shpallur brain - dead (vdekje truri) organet e të cilit largohen për transplantim.
<b>E</b>	Operim emergjent i çfarëdo lloji (përdoret për të modifikuar cilëndo nga klasifikimet e mësipërme, p.sh. ASA III - E)

**ASA I dhe II:** Klasifikohen si pacientë të qëndrueshëm, në këto raste bëhet vetëm vlerësim i historisë së tyre mjekësore.

**ASA III dhe IV:** Klasifikohen si pacientë me rrezik, prandaj kërkohet konsulta me mjekët e tyre familiar ose specialistët përkatës.

## ***8. Përgatitja për sedatim inhalator***

### ***8.1 Përgjegjësitë e stomatologut referues***

**D** Pas diskutimit të metodave alternative të menaxhimit të dhimbjes me pacientin, profesionisti që referon duhet të pajtohet se kujdesi i ofruar me referim është sedatimi inhalator sipas definicionit.

**4**

Është detyrë edhe e profesionistit referues edhe e stomatologut, ofrimi i trajtimit me sedatim për të inkurajuar pacientin të kërkojë vazhdimin e trajtimit stomatologjik.

### ***8.2 Përgjegjësitë e stomatologut trajtues***

**D** Stomatologu i cili ofron trajtimin me sedatim duhet ta informojë profesionistin referues rreth planit të trajtimit dhe trajtimit të ofruar.

**4**



### 8.3 Anamneza

- A** Duhet të mirret anamneza e detajuar: mjekësore, dentare dhe sociale me theks të veçantë në barnat e përkrahura (dhe jo të përkrahura nga mjeku) që të sigurohet se teknika e zgjedhur e sedatimit është më e duhura për të trajtuar pacientin. **4**

### 8.4 Egzaminimi dhe planifikimi i trajtimit

- A** Gjithmonë kur është e mundur duhet të zbatohet egzaminimi oral dhe planifikimi i trajtimit si pjesë e vlerësimit dhe duhet të determinohet dhe regjistrohet statusi ASA. **4**
- D** Duhet të kërkohet këshilla nga specialisti nëse ka dyshime mbi impaktin e statusit fizik të pacientit në sedatim.

## **9. Pëlqimi**

- A** Duhet të merret pëlqimi valid me shkrim (për fëmijët nën moshën 18 vjeç nga prindi/kujdestari), përveç nëse pacienti nuk është në gjendje të plotësojë formularin e pëlqimit. Duhet të mirret pëlqimi valid me shkrim para premedikimit ose administrimit të sedativëve përveç nëse pacienti është i pa aftë të plotësojë formularin e pëlqimit. Në rast të personave mbi 16 vjeç të cilët nuk janë të aftë plotësisht të kuptojnë natyrën dhe implikimet e trajtimit të propozuar për shkak të kapacitetit të ulët mental, duhet të zbatohet kodi mjekësor. **4**
- D** Duhet të mirret anamneza dhe të egzaminohet detajisht pacienti në mënyrë që të klasifikohet sipas ASA. Vetëm pacientët që i përmbushin kriteret e ASA I dhe II mirren parasysh për sedacion në kushte jashtëspitalore. Për fëmijët rekomandohet që vetëm pacientët e kategorisë ASA I të sedatohen jashtë kushteve spitalore. Bëhet egzaminim i detajuar i rrugëve të frymëmarrjes për hipertrofi adenotonzillare ose abnormalitet anatomi të rrugëve të frymëmarrjes.
- D** Nëse pacienti ka ndonjë gjendje shëndetësore ose kirurgjike duhet të konsultohet specialisti përkatës para fillimit të trajtimit stomatologjik. **4**

## **10. Udhëzimet para dhe pas sedacionit inhalator**

- A** Para procedurës, pacientët duhet të marrin udhëzime verbale dhe me shkrim në lidhje me efektet e sedatimit inhalator të propozuar, ndjesinë, kohëzgjatjen e tij mundësitë e komplikimeve dhe përgjegjësitë e pacientit si para ashtu edhe menjëherë pas trajtimit. **4**

Shembulli i instruksioneve pre dhe postoperative gjindet në Apendiks 1.



### 11. Ushqimi para sedacionit inhalator

Nuk ka nevojë për dietë para sedatimit inhalator pos nëse ka indikacion specifik.

- D** Pacientët këshillohen të hanë ushqim të lehtë deri dy orë para intervenimit, të shmangin pijet alkoolike dhe vaktet e mëdha. Marrja e ushqimit dhe lëngjeve duhet të konfirmohet dhe evidentohet. **4**

### 12. Shoqërimi i pacientit në trajtim

- A** Preferohet që pacienti të ketë shoqërues i cili do ta përcjellë në shtëpi pas trajtimit me sedatim inhalator dhe do të qëndrojë me të pjesën tjetër të ditës. **4**

Përgjegjësia e përcjellësit zgjerohet në sigurimin se pacienti i merr normal mediakmentet e përshkruara dhe zbaton proceset rutine të cilat nevoiten për menaxhim të çdo gjendje kronike shëndetësore. **4**

Pacienti i rritur i vetëm që merr sedacion me N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>, normalisht nuk ka nevojë për shoqërim.

### 13. Premedikimi oral

Roli i premedikimit oral është ti ndihmojë pacientit në menaxhimin e anksozitet para trajtimit dhe nuk është teknikë definitive e sedatimit. **4**

- D** Premedikimi oral me dozë të ulët të benzodiazepinës mund të përshkruhet për ti ndihmuar pacientit të flejë natën para trajtimit ose ti ndihmojë pacientit nën anksozitet të udhëtojë nën mbikqyrje të afërt deri në trajtim. **4**

Pacientët të cilët do të pranojnë premedikimin oral duhet të marrin instrukcionet e duhura pre dhe post operative. **4**

### 14. Monitorimi

- A** Të gjithë anëtarët e ekipit stomatologjik duhet të jenë të aftë të monitorojnë gjendjen e pacientit. **4**

**D** Gjatë sedatimit inhalator me Azot Oksidul në përgjithsi është adekuat pa paisje përcjellëse elektronike, mjafton monitorimi klinik i pacientit me pulsoksimetër. **4**

Monitorimi shtesë me paisje elektromekanike mund të jetë i nevojshëm për shembull kur trajtohen pacientë me shkallë të konsiderueshme të sëmundjeve kardiovaskulare.

- D** Çdo aparat elektronik duhet ti përshtatet moshës adekuate. **4**

Obzervimet klinike të pacientit duhet të zbatohen gjatë çdo trajtimi stomatologjik. Stomatologu ose individi i trajnuar/licencuar (sipas udhëzimeve/nën udhëheqjen e tij) duhet të qëndrojë në sallë gjatë trajtimit aktiv stomatologjik për të monitoruar pacientin gjatë gjithë kohës derisa të plotësohen kushtet për lirim në hapësirën për këndellje. Ai duhet ti dijë teknikat e monitorimit dhe ti njohë paisjet.

Gjatë sedatimit inhalator me  $N_2O/O_2$  vazhdimisht duhet të monitorohen:

- **Vetëdija e pacientit** (niveli i vetëdijes, thellësia e sedacionit)
  - përgjigjja e pacientit ndaj komandave (verbale, taktile), gjatë trajtimit nën sedacion ihhalator shërben si orientim ndaj nivelit të tij të vetëdijes. Përgjigjet me fjalë ofrojnë indikacion se pacienti po merr frymë.
- **Oksigjenimi:** (kalueshmëria e rrugëve të frymëmarrjes)
  - duhet të vlerësohen vazhdimisht ngjyra e mukozës, lëkura ose gjaku.
  - duhet të mirret parasysh saturimi i  $O_2$  me puls oksimetër.
- **Ventilimi:**
  - vazhdimisht duhet të vëzhgohen lëvizjet e krahorrit.
  - vazhdimisht duhet të vërtetohen respirimet.
- **Qarkullimi i gjakut:**
  - shtypja e gjakut dhe pulsi vlerësohen para, gjatë dhe pas intervenimit ose sa herë të nevojitet (pos nëse pacienti nuk mund ti nënshtrohet vëzhgimeve të shpeshta)
- **Kontrolli adekuat i dhimbjes** (anestezioni adekuat)

Nëse përdoret ndonjë agjent tjetër farmakologjik si shtesë e  $N_2O/O_2$  dhe anestetikut lokal duhet të përcillen udhëzuesit për nivelin e duhur të sedatimit.

## 15. Dokumentimi

Për secilin pacient, duhet të mbahen të dhënat për vlerësimin preoperativ, vizitë sedatim inhalator, procedurë të trajtimit dhe këndelljes.

**A** Të dhënat klinike gjithëpërfshirëse dhe bashkëkohore duhet të mbahen për çdo pacient dhe të ofrohen dëshmi për të mbështetur procesin formal të pëlqimit.

Detaje tjera mbi informatat që duhet të regjistrohen gjinden në Apendiks 2.

Duhet të mbahen shënimet e sedatimit, të shënohen saktësisht emrat e të gjitha barnave të administruara duke përfshi anestetikët lokal, dozat dhe të monitorohen parametrat fiziologjik.



Duhet të mirret pëlqimi nga prindi dhe të dokumentohet në kartelën e pacientit para aplikimit të N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>. Nëse indikohen duhet ti ofrohen instrukcionet prindit në lidhje ushqim para trajtimit. Kartela e pacientit duhet ti përfshijë indikacionet për përdorim të sedatimit inhalator me N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>, dozën e tij (p.sh. përqindjen e gazrave ose sasinë e qarkullimit) kohëzgjatjen e trajtimit dhe procedurën e oksigjenimit postoperativ.

**D** Këshillohet që çdo shmangje nga udhërrëfytyesi të dokumentohet plotësisht në kartonin e pacientit në kohën kur mirren vendimet. **4**

## **16. Rikuperimi nga sedacioni inhalator**

Rikuperimi nga sedacioni inhalator paraqet këndelljen progresive të vetëdijes së pacientit nga përfundimi i trajtimit, deri te lirimi i pacientit në shtëpi. Fëmijët detyrimisht duhet të jenë nën përcjelljen e prindit/kujdestarit.

Këndellja nga sedatimi paraqet rikthimin progresiv nga përfundimi i trajtimit deri te lirimi i pacientit nën kujdesin e përcjellësit të rritur të ndërgjegjshëm. **4**

**A** Anëtari i trajnuar i ekipit stomatologjik duhet të jetë përgjegjës për monitorim të pacientit përgjatë kësaj periudhe dhe të dyjat edhe barnat edhe paisjet për menaxhimin e komplikimeve të sedatimit duhet të jenë në dispozicion. Personi që bën sedatim duhet të shoh urgjencën tek pacienti në rast se shfaqet çfarëdo problemi. **4**

**D** Salla e rikuperimit mund të jetë dhomë e veçantë apo salla e njejtë ku bëhet trajtimi. **4**

## **17. Lirimi i pacientit**

**D** Të gjithë pacientët duhet të vlerësohen në mënyrë individuale për përshtatshmëri për lëshim dhe lejohen të largohen nga ordinanca vetëm pasi të kthehen në nivelin normal të reagimit dhe orientimit për moskë dhe status mental dhe mund të hecin pa ndihmë. **4**

**A** Kur aplikohet kanula në venë duhet të qëndrojë in situ derisa të vlerësohet se pacienti është i gatshëm për tu liruuar. **4**

Vendimin për lirim të pacientit pas çdo lloji të sedatimit duhet të jetë përgjegjësi e personit që e ka kryer sedatimin.

## **18. Udhëzimet për kujdesin në shtëpi pas sedacionit inhalator**

**D** Pacientit dhe shoqëruesit duhet i jepen informacione të detajuara në formë të shkruar për rreziqet, kontrollin e dhimbjes dhe menaxhimin e komplikimeve të mundshme pas sedacionit. Poashtu i ipet informacioni mbi masat e kujdesit shtëpiak dhe numri kontaktues i urgjencës. **4**

Mostra e instruksioneve pre dhe post operative është dhënë në Apendiksin 1.



## 19. Sedacioni inhalator me ruajtje të vetëdijes për fëmijët

Dihet se zhvillimi fizik dhe mendor i fëmijëve ndryshon dhe nuk lidhet domosdoshmërisht me moshën e tyre. Është thelbësore që zgjedhja e teknikës së sedacionit të bazohet në vlerësim të plotë individual të fëmijut.

**A** Sedatimi inhalator për fëmijë duhet të ofrohet vetëm nga personeli i trajnuar me përvojë në sedatimin e fëmijëve dhe kur janë në dispozicion paisjet dhe aparatura e duhur.

**D** Përgjigjja e fëmijut ndaj ambientit dhe intervenimit dallon, ndikohet nga faktorë si aftësia e shkallës kognitive, kooperimi dhe ndikimi e historisë së tyre mjekësore për trajtimin e propozuar. Mund të nevoiten adaptime në protokole të trajtimit: psh nuk mund të bëhet regjistrimi preoperativ i të dhënave fiziologjike ose egzaminimi intraoral. Në raste të tilla duhet të regjistrohen shkaqet e devijimit nga praktika standarde.

Revju sistematike Cochrane ka gjetur dëshmi për shumë teknika të cilat përdoren me sukses për sedatim inhalator të fëmijët në mënyrë të sigurtë dhe efektive.

